

|                                   |              |
|-----------------------------------|--------------|
| 1.3.1                             | Cowslip root |
| SPC, Labeling and Package Leaflet | KO-Kosovo    |



## FLETUDHËZIM: INFORMATA PËR PËRDORUESIN

### **Herbion® shurup aguliçe** ekstrakte të aguliçes dhe trumzës për ekspektorim

#### **Lexojeni këtë fletudhëzim të tërin me kujdes sepse përmban informata të rëndësishme për ju.**

Ky bar është në dispozicion pa recetë. Megjithatë, ju duhet të merrni Herbion shurup aguliçe me kujdes për të përfituar rezultatet më të mira prej tij.

- Ruajeni këtë fletudhëzim. Mund t'ju duhet ta lexoni përsëri.
- Nëse keni pyetje ose kërkonti këshilla të tjera, drejtojuni farmacistit.
- Duhet t'a kontaktoni mjekun nëse simptomat ju përkeqësohen ose nuk përmirësohen pas 5-7 ditësh.
- Nëse cilido nga efektet anësore përkeqësohet, ose nëse vëreni ndonjë efekt anësor që nuk figuron në këtë fletudhëzim, ju lutemi tregojini mjekut ose farmacistit.

#### **Në këtë fletudhëzim:**

1. Çka është Herbion shurup aguliçe dhe për se përdoret
2. Para se të merrni Herbion shurup aguliçe
3. Si të merrni Herbion shurup aguliçe
4. Efektet e mundshme anësore
5. Si ta ruani Herbion shurup aguliçe
6. Informata shtesë

## **1. ÇKA ËSHTË HERBION SHURUP AGULIÇE DHE PËR SE PËRDORET**

Herbion shurup aguliçe për ekspektorim përmban ekstrakt të lëngshëm të përzierjes nga rrënjët e aguliçes dhe nga barishta e trumzës së kopshtit.

Herbion shurup aguliçe është bar herbal tradicional i cili rekomandohet për lehtësimin e ekspektorimit të ftohjet (gripi) e shoqëruara me kollë.

Herbion shurup aguliçe është bar herbal tradicional përdorimi i të cilit për indikimet e mësipërme bazohet vetëm në përvojën afatgjatë.

## **2. PARA SE TË MERRNI HERBION SHURUP AGULIÇE**

#### **Mos merrni Herbion shurup aguliçe:**

- nëse jeni alergjik në ekstraktin e rrënjës së aguliçes, ekstraktin e barishtës së trumzës, bimë të tjera të gjinisë së *Primula* apo bimë të tjera të familjes *Lamiaceae*, ose në ndonjë prej përbërësve të këtij bari (listuar në seksionin 6);
- nëse keni astmën;
- nëse fëmija juaj ka pasur në të kaluarën inflamacion të rëndë të fytit dhe kordeve vokale.

#### **Tregoni kujdes të veçantë me Herbion shurup aguliçe**

- nëse ju keni vështirësi të frymëmarrjes, temperaturë apo pështymë purulente (pështyma përmban qelb), ju duhet të vizitoni mjekun tuaj menjëherë;
- nëse ju jeni një pacient diabetik, ju duhet të jeni të vetëdijshëm se shurupi përmban saharezë dhe nuk rekomandohet për ju;
- kujdes të veçantë nëse ju keni inflamacion të mukozës së membranës gastrike apo ulçerë gastrike.

|                                   |              |
|-----------------------------------|--------------|
| 1.3.1                             | Cowslip root |
| SPC, Labeling and Package Leaflet | KO-Kosovo    |



### **Fëmijët**

Shurupi nuk rekomandohet për fëmijët nën moshën 4 vjeçare pa u këshilluar së pari me mjekun.

### **Marrja e barnave tjera**

Ju lutem tregojini mjekut ose farmacistit tuaj nëse jeni duke marrë ose keni marrë barna të tjera kohëve të fundit, duke përfshirë barna që merren pa recetën e mjekut.

Nuk ka të dhëna se Herbion shurup aguliçe ndikon në efektin e barnave tjerë.

### **Marrja e Herbion shurup aguliçe me ushqim dhe pije**

Nuk ka raportime të interaksioneve me ushqim.

Rekomandohet që gjatë marrjes së shurupit të pihet çaji ose pije të tjera të ngrohta.

Mos hani ose pini menjëherë pas marrjes së barit sepse ushqimi dhe pirja mund të përshpejtojnë largimin e barit nga mukoza e gojës dhe e fytit.

### **Shtatzënia dhe gjdhënia**

Kërkojini këshillë mjekut ose farmacistit para përdorimit të barnave.

Nëse jeni shtatzënë, mendoni se jeni shtatzënë ose planifikoni të keni foshnje, bisedoni me mjekun tuaj ose farmacistin para se të merrni këtë bar.

Meqë nuk ka të dhëna të mjaftueshme mbi sigurinë e përdorimit gjatë shtatzënisë dhe ushqyerjes me gjë, nuk rekomandohet përdorimi i Herbion shurup aguliçe gjatë kësaj periudhe.

### **Ngasja dhe përdorimi i makinerive**

Nuk ka të dhëna se bari ndikon në aftësinë për të drejtuar automjete ose për të përdorur makineri.

### **Informata të rëndësishme për disa nga përbërësit e Herbion shurup aguliçe**

#### **Herbion shurup aguliçe përmban saharozë dhe metil parahidroksibenzoat (E218).**

Nëse ju është thënë nga mjeku juaj se keni intolerancë ndaj disa sheqernave, kontaktoni mjekun para përdorimit të shurupit.

Metil parahidroksibenzoat mund të shkaktojë reaksione alergjike (janë të mundshme reaksionet e vonuara).

## **3. SI TË MERRET HERBION SHURUP AGULIÇE**

Gjithmonë merrni Herbion shurup aguliçe saktësisht siç ju ka udhëzuar mjeku. Duhet të konsultoheni me mjekun ose farmacistin nëse nuk jeni të sigurt. Doza e zakonshme është:

### **Përdorimi te fëmijët dhe të rriturit**

Doza e rekomanduar për të rriturit dhe fëmijët mbi 12 vjeç është 1 lugë dozuese e shurupit 4 herë në ditë.

Fëmijët nga 4 deri në 12 vjeç duhet të marrin 1 lugë dozuese të shurupit 3 herë në ditë.

Përdorimi te fëmijët nën moshën 4 vjeçare nuk rekomandohet.

Nuk duhet të hani apo pini menjëherë pas marrjes së barit për shkak se ushqimi dhe pijet mund të përshpejtojnë heqjen e barit nga mukoza e membranës së gojës dhe fytit.

|                                   |              |
|-----------------------------------|--------------|
| 1.3.1                             | Cowslip root |
| SPC, Labeling and Package Leaflet | KO-Kosovo    |



Rekomandohet që gjatë marrjes së shurupit të pihet shumë çaj ose pije të tjera të ngrohta.

Nëse simptomet nuk largohen pas 1 jave, bisedoni me mjekun apo farmacistin.

Tundeni shishen para përdorimit. Mbylleni mirë shishen pas përdorimit.

#### **Nëse merrni Herbion shurup aguliçe më shumë se ç’duhet**

Mos merrni doza më të larta se ato që ju janë përshkruar. Marrja e dozave shumë të larta të barit mund të shkaktojë çrregullime gastrointestinale, të cilat manifestohen si nauze, vjellje dhe diarje (barkqitje).

#### **Nëse harroni të merrni Herbion shurup aguliçe**

Mos merrni dozë të dyfishtë për ta kompensuar dozën e harruar.

Merreni dozën e harruar sa më shpejt të jetë e mundur vetëm nëse është tashmë koha për të marrë dozën tjetër të rradhës. Në këtë rast, lëreni dozën e harruar.

#### **Nëse e ndërprisni marrjen e Herbion shurup aguliçe**

Në rast se keni pyetje të mëtejme lidhur me përdorimin e këtij produkti, drejtohuni mjekut ose farmacistit.

### **4. EFEKTET ANËSORE TË MUNDSHME**

Sikurse të gjitha barnat, Herbion shurup aguliçe mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo te të gjithë paraqiten ato.

Kur merret sipas dozave të rekomanduara, shurupi nuk shkakton efekte të padëshirueshme.

Të panjohura (frekuenca nuk mund të vlerësohet në bazë të të dhënave të disponueshme)

- *Çrregullime të sistemit imun*  
reaksione alergjike, rekasionet të mbindjeshmërisë (në rastet më të rënda kruarje e fytyrës së ënjtur, gjuhës dhe mukozës së membranës së gojës dhe fytyrës, si - Quincke’s edema).
- *Çrregullime gastrointestinale*  
probleme me lukth, nauze dhe vjellje.

#### **Paraqitja e efekteve anësore**

Nëse ju paraqitet çfarëdo efekti anësor, duhet që të lajmëroni mjekun ose farmacistin. Kjo përfshin çdo efekt anësor që nuk është dhënë në këtë fletudhëzim. Efektet anësore mund të paraqiten drejtpërsëdrejti nëpërmjet sistemit nacional të raportimit. Me paraqitjen e efekteve anësore mund të ndihmoni në vlerësimin e sigurisë së këtij bari.

Nëse ndonjë efekt anësor përkeqësohet, ose nëse vëreni ndonjë efekt anësor që nuk figuron në këtë fletudhëzim, ju lutemi njoftojeni mjekun ose farmacistin tuaj.

### **5. SI TË RUHET HERBION SHURUP AGULIÇE**

Mbajeni larg syve dhe duarve të fëmijëve.

|                                   |              |
|-----------------------------------|--------------|
| 1.3.1                             | Cowslip root |
| SPC, Labeling and Package Leaflet | KO-Kosovo    |



Mos e përdorni Herbion shurup aguliçe pas datës së skadimit e cila është e shënuar në karton pas EXP. Data e skadimit i referohet ditës së fundit të atij muaji.

Para hapjes së shishes:

Ky bar nuk kërkon ndonjë kusht special për ruajtje.

Pas hapjes së shishes:

Të ruhet në temperaturë deri në 25°C. Shurupi duhet të përdoret brenda 3 muajve pas hapjes së shishes.

Barnat nuk duhet të hidhen nëpërmjet kanalizimit ose mbeturinave të shtëpisë. Pyeteni farmacistin se si t'i hidhni barnat që nuk ju duhen më. Këto masa do të ndihmojnë për ta ruajtur mjedisin.

## 6. INFORMATA SHITESË

### Çka përmban Herbion shurup aguliçe

Substancat aktive është: ekstrakt të lëngshëm të përzierjes nga rrënjët e aguliçes dhe herbes së trumzës. 5 ml (1 lugë dozuese) shurup, përmban 3,08 g të përzierjes së ekstraktit të lëngshëm nga rrënjët e aguliçes (*Primulae veris* L. dhe/ose *Primula elatior* (L.) Hill, *radix*) dhe ekstraktit të lëngshëm nga herba e trumzës së kopshtit (*Thymus vulgaris* L. dhe/ose *Thymus zygis* L., *herba*), që është ekuivalent në 0,22 në 0,51 g të rrënjës së aguliçes dhe 0,62 g të trumzës së kopshtit.

Tretësi ekstraktues: ujë.

Përbërësit e tjerë janë: levomentol, saharozë, metil parahidroksibenzoat (E218).

### Si duket Herbion shurup aguliçe dhe përbërja e paketimit

Shurupi është ngjyrë kafe dhe ka shije dhe aromë karakteristike.

Shurupi është në dispozicion në kuti me 150 ml shurup në një shishe së bashku me një lugë dozuese.

### Mënyra e dhënies së barit

Bari jepet pa recetë të mjekut.

### Mbajtësi i Autorizimit për Marketing dhe Prodhuesi

KRKA, d.d., Novo mesto, Šmarješka cesta 6, 8501 Novo mesto, Slloveni

tel: +386 7 331 28 84,

fax: +386 7 332 27 42

[www.krka.si](http://www.krka.si)

### Ky fletudhëzim së fundmi është miratuar në

06/2024.